

## **LICENCË PËR GJENERIM TË NGROHJES QENDRORE (ME KUSHTE)**

**DHËNË:**

***"NGROHTORES SË QYTETIT GJAKOVA" SH.A.***

**Numri i Regjistrimit: ZRRE\_Li\_02/06**

**TABELA E PËRMBAJTJES**

<b>PJESA I</b>	<b>TERMAT E LICENCËS</b> .....	<b>3</b>
<b>PJESA II</b>	<b>KUSHTET E LICENCËS</b> .....	<b>4</b>

Neni 1: Përkufizimet dhe Interpretimet.....	4
Neni 2: Llogaritë e Ndara për Biznesin e Gjenerimit të Energjisë Termale .....	5
Neni 3: Ndalimi i Subvencionimeve dhe Ndër-subvencionimeve .....	6
Neni 4: Ndalimi i Diskriminimit.....	6
Neni 5: Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin Matës dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithëshme të Furnizimit me Energji.....	7
Neni 6: Marëveshjet për Sigurimin e Karburantit.....	7
Neni 7: Shëndeti dhe Siguria.....	8
Neni 8: Mjedisi.....	8
Neni 9: Puna .....	8
Neni 10: Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve të të Licencuarit.....	9
Neni 11: Obligimi i Sigurimit .....	9
Neni 12: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit.....	9
Neni 13: Sigurimi i Informacionit ndaj ZRRE-së .....	9
Neni 14: Arsyet për Përfundimin, Tërheqjen dhe Modifikim e Licencës .....	10
Neni 15: Taksat .....	11
Neni 16: Masat dhe Gjobat Administrative.....	11
Neni 17: Zgjidhja e Kontesteve.....	12

**Shtojca 1** Stacionet e Gjenerimit për të cilët aplikohet Licenca (përshkrimi i paisjeve dhe të njëjseve gjeneruese – vizatimet përkatëse).

**Shtojca 2** Përshkrimi i teknologjisë dhe kategorisë së karburantit të përdorur për gjenerim të ngrohjes.

**Shtojca 3** Përshkrimi i Grupit të të Licencuarit (aksionarve, ortakët dhe vartësit e të Licencuarit-diagrami, referenca ndaj disa përqindjeve të pjesëmarrjes aksionare dhe aktivitetet e ushtruara nga secila prej kompanive.

## PJESA I    TERMAT E LICENCËS

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin në vazhdim e referuar si "ZRRE")**, në ushtrimin e pushtetit të dhën nga Nenet 15 paragrafi 2 (a), 28.2 dhe 37 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (që tash e tutje i referuar si "Ligji"), Nenit 16.2 të Ligjit për Energji (Ligji 2004/8), Nenet 5.2 dhe 5.3 të Ligjit për Ngrohje Qëndrore dhe Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë me këtë i lëshonë, **Ngrohtores së Qytetit "GJAKOVA" SH.A.** (në tekstin në vazhdim do të referohet si i "**Licencuari**") **licencë për gjenerim të ngrohjes** në stacionin e gjenerimit të identifikuar në Shtojcën 1 dhe me përshkrimin e teknologjisë dhe kategorisë së karburantit të përdorur për kryerjen e gjenerimit të ngrohjes në Shtojca 2 gjatë periudhës së specifikuar në paragrafin 6, duke ju nënshtuar Neneve dhe kushteve të vendosura në Pjesën II.
- 2 I Licencuari është i obliguar që të veproj në pajtueshmëri me tërë Legjislacionin e aplikueshëm, Nenet dhe kushtet e kësaj licence.
- 3 I Licencuari ka të drejtë:
  - a) të përdor gjatë procesit të gjenerimit të energjisë termale ato resurse primare të energjisë që ai konsiderohen se janë më të përshtatshme, me kusht që të jenë në përputhje me karakteristikat teknike dhe kriteret ekologjike që janë në aktet përkatëse;
  - b) të lidhë stabilimentet e tij të ngrohjes me Sistemin e shpërndarjes sipas kushteve të vendosura në Ligjin për Ngrohje Qëndrore;
  - c) lidh kontrata për shitje të energjisë termale sipas kushteve të Ligjit për Ngrohje Qëndrore dhe rregullave të përshkruara nga ZRRE-ja;
  - d) bartë energjinë termale të tij përmes sistemit të shpërndarjes;
  - e) marr pagesën për atë që i takon me kontratë.
4. I Licencuari që prodhon energji termale me kapacitet më të madh se 1 MW, është i obliguar të shes energjinë termale të prodhuar tek Furnizuesi Publik sipas dispozitave të Ligjit për Ngrohje Qendrore.
5. Nenet dhe kushtet ju nënshtrohen modifikimit ose ndërprerjes ose tërheqjes ose monitorimit në përputhje me termet e tyre dhe nenet 35, 36, 37 dhe 39 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
6. Kjo licencë do të hyj në fuqi me 04 Tetor 2006 dhe, përderisa të tërhiqet, do vazhdoi me fuqi dhe ndikim të plotë gjatë kohëzgjatjes teknike të pjesëve kryesore të stacionit ekzistues që përdoren për kryerjen e aktiviteteve relevante dhe politikës amortizimit të të Licencuarit që është dërguar së bashku me aplikacionin, për një periudhë **pesëmbëdhjetë (15) vjeçare**, deri me 04 Tetor 2021 me mudësi vazhdimi sipas Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

E vulosur me Vulën e zakonshme të Zyrës së Rregullatorit për Energji me \_\_\_\_\_

E nënshkruar (në emër të Bordit të ZRRE-së) \_\_\_\_\_

## **PJESA II KUSHTET E LICENCËS**

### **Neni 1: Përkufizimet dhe Interpretimet**

1. Për qëllim të kësaj licence, termat dhe shprehjet e rënditura mëposhtë do të kenë kuptimin në vazhdim:

**"Anëtar"** nënkupton në marrëdhënie të drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo Kompani Aksionare apo vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës të një Kompanie Aksionare të të Licencuarit, në secilin rast brenda kuptimit të legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë.

**"Shpërndarje"** ka kuptimin e dhënë me Nenin 3.1 të Ligjit për Ngrohje Qendrore.

**"Kodi i Shpërndarjes"** ka kuptimin e dhënë me Nenin 3.1 të Ligjit për Ngrohje Qendrore.

**"Viti Financiar"** është periudha e raportimit të të Licencuarit për qëllime Rregullative dhe zakonisht përfshinë periudhën prej 15 Tetor të vitit aktual deri me 14 Tetor të vitit të ardhshëm, përveq nëse specifikohet ndryshe me legjislacionin sekondar relevant të nxjerrur nga ZRRE.

**"Ngrohje apo Energji Termale"** ka kuptimin e dhënë me Nenin 3.1 të Ligjit për Ngrohje Qendrore.

**"Rrjeti i Shpërndarjes së Ngrohjes"** nënkupton sistemin e gypave që transportojnë ngrohje nga prodhuesit tek konsumatorët.

**"Ndërmarrje e Ngrohjes"** ka kuptimin e dhënë me Nenin 3.1 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore.

**"Sistemi i Ngrohjes"** nënkupton sistemin e integruar dhe të kyçur të gjenerimit, shpërndarjes dhe furnizimit.

**"Legjislacioni"** nënkupton Ligjin për Energji (2004/8), Ligjin për Energji Elektrike (2004/9), Ligjin për Ngrohje Qendrore dhe çdo legjislacion tjetër primar apo sekondar që do të nxirret për të ekzekutuar legjislacionin primar e që do të ndërlidhet me ngrohje.

**"Kodi Matës"** ka kuptimin e dhënë me Nenin 3.1 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore.

**"Paisje matëse"** ka kuptimin e dhënë në Ligjin për Ngrohjen Qendrore.

**"Modifikim"** përfshinë shtimin, përmirësimin dhe shprehjet e ndërlidhura që do të ndërtohen në përputhje.

**"Prodhues" dhe "gjenerues"** nënkupton si pasojë një person juridik që gjeneron energji termale.

**"Biznese të ndara"** nënkupton çdo biznes të licencuarit tjetër nga ai i Biznesit të

Gjenerimit të Energjisë Termale.

**"Furnizim"** nënkupton dërgimin dhe shitjen ose rishitjen e energjis termale tek Konsumatorët.

**"Gjenerimi i energjisë Termale"** nënkupton gjenerimin e energjisë termale nga një ndërmarrje e licencuar për të prodhuar këtë energji termale.

**"Energjia termale e papërdorur"** nënkupton tepricën e energjisë termale të prodhuar nga fabrikat, termocentralet, që aktualisht hidhet dhe e cila mund të përdoret për ngrohje qendrore.

2. Termat e përdorura në këtë licencë do të kenë kuptimin e njëjtë me termat e përdorura në këtë në Legjislacion.
3. Duke ju referuar paragrafit (2) çdo modifikim ose ri-dekretim i legjislacionit pas datës kur kjo licence hyn në fuqi, do të aplikohet.
4. Përveq nëse specifikohet ndryshe:
  - a) çdo referim të bërë ndaj Neneve të numruar ose Shtojcës është referencë përkatëse ndaj Nenit ose Shtojcës që ka atë numër në këtë licencë;
  - b) do referim të bërë ndaj paragrafit të numruar është referencë përkatëse ndaj paragrafit që ka atë numër në Nen apo Shtojcë në të cilën referenca paraqitet.
5. Emri ose titulli i çdo Pjese, Neni, Shtojce ose paragrafi nuk do të ndikoj në përmbajtje.
6. Kur të Licencuarit i imponohet për të kryer një detyrim brenda një afati të specifikuar, ai detyrim duhet të vazhdojë të jetë detyrues dhe në fuqi edhe pas atij afati kohor, pa marrë parasysh masat administrative dhe gjobat që mund të vendosen kundër të Licencuarit, nëse ky i fundit nuk arrin të kryejë aktivitetin e duhur brenda afatit kohor.
7. Dispozitat e paragrafit 6 do të aplikohen në çdo dokument që do të paraqitet ose, udhëzimi, njoftimi dhe shërbimi që duhet të kryhet sipas kësaj licence dhe udhëzimeve të lëshuara prej ZRRE-së..

## **Neni 2: Llogaritë e Ndara për Biznesin e Gjenerimit të Energjisë Termale**

### **Kushti 1**

Në pajtim me Nenin 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë i Licencuari duhet të veprojë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e këtij Neni brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e lëshimit të kësaj licence. Për të qenë në pajtueshmëri me këtë Kusht, ZRRE mund ti jap të Licencuarit një urdhëres me orar kohor specifik të implementimit.

1. I Licencuari do të përgadisë llogaritë vjetore rregullative në përputhje me udhëzimet e përkohëshme të ZRRE-së në raportimet rregullative dhe do ti dërgoj ZRRE-së një kopje të deklaratës/llogarive të audituara vjetore të pregatitur sipas orarit kohorë/legjislacionit sekondar relevant të lëshuar nga ZRRE.
2. I Licencuari në kontabilitetin e tij të brendshëm do të mbajë kontabilitetin për biznesin Gjenerues të energjisë termale në tërësi, e cila kërkohet kohë pas kohe nga ZRRE-ja, dhe do t'i dorëzohet në formën dhe datën e specifikuar nga ZRRE-ja. Kontabiliteti rregullativ do të jetë në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet, që nxirren kohë pas kohe nga ZRRE-ja
3. Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet ose udhëzimet që ZRRE-ja i njofton të Licencuarit sipas paragrafit 2, ndër të tjerash mund të:
  - a) specifikojnë formën e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm nga llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, bilancet, fitimet e njohura dhe deklaratat e humbjeve, rrjedhjen e parave të gatshme dhe deklaratat për shumat e të ardhurave vjetore, kostove, asetëve, borxheve, rezervave ose furnizimeve, të cilat janë tarifuar nga ndonjë biznes tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis bizneseve gjenerues të energjisë termale të konsoliduar dhe ndonjë biznesi tjetër;
  - b) të specifikojë natyrën dhe përmbajtjen e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, asetëve ose borxheve, dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, asetet, shpenzimet dhe borxhet nga aktivitetet e specifikuara;
  - c) Të specifikoj parimet rregullative të kontabilitetit (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
4. Në lidhje me deklaratat e kontabilitetit rregullativ për sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk do të ndryshojë bazat e tarifimit, shpërndarjes ose alokimit që janë përdorur në vitin financiar paraparak, përveçse nëse ZRRE-ja nxjerr më parë udhëzimet për qëllimet e këtij Kushti, ku i drejtohet të Licencuarit që të ndryshojë këto baza sipas mënyrës së përcaktuar në udhëzim, ose nëse ZRRE-ja jep paraparakisht aprovimin me shkrim për ndryshimin e këtyre bazave.
5. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me çdo udhëzim të lëshuar nga ZRRE-ja e për qëllime të këtij Neni.

### **Neni 3: Ndalimi i Subvencionimeve dhe Ndër-subvencionimeve**

I Licencuari do të siguroi që Bizesi i Gjenerimit të Energjisë Termale nuk jep ndonjë ndërsuvencionim të drejtpërdrejt ose indirekt në mes të bizneseve të ndryshme të ndërlidhura me të dhe as nuk merr ndonjë subvencionim nga ndonjë person tjetër.

### **Neni 4: Ndalimi i Diskriminimit**

1. I Licencuari do të siguroi që Biznesi i Gjenerimit të Energjisë Termale nuk zbulon drejtpërdrejt ose indirekt ndonjë informatë konfidenciale të ndonjë biznesi tjetër të

të licencuarit apo Vartësi ose të ndonjë sipërmarrjeje të ndërlidhur me të Licencuarin.

2. I Licencuari nuk do të shesë e as do të ofrojë shitjen e ngrohjes ndonjë blerësi ose personi që kërkon të bëhet blerës me çmime të cilat materialisht, janë më shumë a më pak të favorshme, sesa ato me të cilat i Licencuari do të shesë ose ofrojë sigurimin e ngrohjes ndaj blerësve të krahasueshëm.
3. I Licencuari në ç' do kohë do t'i zbuloj ZRRE-së rrethanat e furnizimit të tillë, përfshirë (pa kufizim) vëllimin, faktorët e ngarkesës, kushtet e ndërprerjes, afatet dhe kohëzgjatjen e marrëveshjeve përkatëse.
4. Duke ju referuar paragrafit 3, i Licencuari do të dorëzoj në ZRRE informatat për:
  - a) furnizimin me ngrohje të ndonjë biznesi për furnizim publik të të Licencuarit ose ndonjë Vartësi apo sipërmarrje të të licencuarit; dhe
  - b) furnizimi me ngrohje përmes marrëveshjes për blerje të energjisë.
5. Duke iu referuar paragrafit 4 për furnizim me ngrohje për çdo person do të përfshijnë dispozitën për kapacitetin në dispozicion të çdo njësie për gjenerim të energjisë termale.

#### **Neni 5: Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin Matës dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithëshme të Furnizimit me Energji**

##### **Kushti 2:**

Në pajtim me Nenin 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, pas konsultimit me të Licencuarin, Operatorin i Sistemit të Shpërndarjes, ZRRE-ja mund ti jap të Licencuarit një orar kohorë për të implementuar këtë Nen. Orari i tillë kohor mund të zbatohet dhe do të ketë shtrirje në ato pjesë të Kodeve siç precizohet në atë orar.

1. I licencuari do të veproj në pajtueshmëri me dispozitat e Kodit të Shpërndarjes dhe Kodit Matës dhe Rregullit për Kushtet e Përgjithëshme të Furnizimit me Energji për aq sa do të jenë të aplikueshme ndaj tij.

#### **Neni 6: Marrëveshjet për Sigurimin e Karburantit**

1. I Licencuari do të përgatis planin për rezervat e karburantit sipas Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore dhe në përputhje me legjislacionin relevant sekondar të lëshuar nga Ministria e Energjisë dhe Minierave.
2. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me çdo dispozitë e cila rregullon llojin dhe sasinë e rezervave minimale të karburantit apo kapaciteteve rezervë, si dhe çdo legjislacion sekondar të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave dhe Kodeve relevante.

## **Neni 7: Shëndeti dhe Siguria**

1. I Licencuari do të marr të gjithë hapat e nevojshëm për të mbrojtur personat dhe pronën nga lëndimet dhe dëmtimet që mund të shkaktohen nga i Licencuari kur është duke kryer Biznese të Gjenerimit.
2. I Licencuari do të siguroi që një ekspert i pavarur, emrimi i të cilit do të aprovohet nga ZRRE-ja, çdo vit do të bëjë auditimin teknik dhe të sigurisë në lidhje me Pajisjet e Gjenerimit.
3. I Licencuari duhet të ofroi në ZRRE, rezultatet e auditimeve të tilla të kryera në afat të duhur kohor.

## **Neni 8: Mjedisi**

### **Kushti 4**

Me qëllim të përmbushjes së këtij Neni, sipas Nenin 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ZRRE-ja mund ti jap të Licencuarit një udhëzim me orar kohorë të implementimit. Orari i tillë kohorë mund të përfshijë afat kohorë prej dymbëdhjetë (12) muajsh për të siguruar lejen për mbrojtje të mjedisit.

1. Brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga lëshimi i kësaj licence, i Licencuari do ti dërgoi ZRRE-së Lejen për Mbrojtjen e Mjedisit të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. I Licencuari do të të veptoi në përputhje me të gjitha legjislacionet e aplikueshme për ambient në Kosovë qofshin ato në fuqi tani ose në të ardhmen.
2. I Licencuari, jo më vonë se me datën që do të specifikohet nga ZRRE-ja dhe në konsultim me ZRRE-në, do të përgadisë dhe kohë pas kohe do të modifikoi një politikë të shkruar që vendosë në mënyrën që I Licencuari propozon të përmbush detyrat e tij dhe obligimet sipas legjislacionit për ambient të aplikueshëm në Kosovë.
3. I Licencuari për çdo vit do të raportoj në ZRRE për kryerjen e veprimtarisë së tij në përputhje me ambientin.
4. Në këtë Licencë:

**"Legjislacioni për ambient"** nënkupton legjislacionin i cili është në fuqi dhe qëllimi i të cilit është mbrojtja e mjedisit duke përfshirë mbrojtjen e shëndetit njëzror, florës, faunës dhe të ekosistemet që ata varen, dhe për qëllim të mënjanimin të dyshimit do të përfshihet por jo kufizohet Ligji për Mbrojtje të Mjedisit dhe të gjitha legjislacionet përkatëse të ndërlidhura me vlerësimet e ndikimit në mjedis, dhe mbrojtjes së ajrit, tokës dhe ujit.

## **Neni 9: Puna**

I Licencuari do të veptoi në pajtueshmëri me legjislacionin e aplikueshëm mbi marrëdhënien në punë dhe sigurinë në punë që tani është në fuqi apo që do të hyj në

fuqi në të ardhmën.

### **Neni 10: Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve të të Licencuarit**

1. I Licencuari do të përgatisë dhe do të mbajë një regjistër të të gjithë asetëve relevante dhe do t'i dorëzojë ZRRE-së këtë regjistër çdo vit jo më vonë se 31 Janar të çdo viti.
2. Në rast kur i Licencuari kërkon që ti tjetërsojë disa asete në pronësi apo në shfrytëzim, apo burimeve tjera në ushtrimin e veprimtarisë së licencuar, i Licencuari obligohet që ta njoftoj ZRRE-në me shkrim. I Licencuari mund ta bëjë tjetërsimin e ndonjë aseti vetëm pas miratimit me shkrim nga ana e ZRRE-së.
3. Njëjtë siç është thënë në paragrafin 1 aplikohet për dhënien në shfrytëzim të asetëve ose resurseve të tjera që përdoren për të përmbushur aktivitetin e licencuar.
4. Në këtë Nen:

“*Aset*” konsiderohet të jetë çdo paisje e luajtshme ose e paluajtshme me një vlerë të rëndësishme e përdorur për ushtrimin e aktivitetit të gjenerimit të ngrohjes.

“*Tjetërsimi*” nënkupton çdo shitje, transferim, dhurim, dhënien me qira, hua, hipotekë, ngarkim, kufizimin mbi shfrytëzimin (qoftë ky fizik ose ligjor), dhënien, ose ndonjë ngarkesë tjetër, si dhe lejinin e ndonjë ngarkese ndaj një Biznesi tjetër të të Licencuarit dhe/ose pale të tretë, dhe “tjetërsimi” do të interpretohet në përputhje me rrethanat.

### **Neni 11: Obligimi i Sigurimit**

#### **Kushti 5**

I Licencuari do të veprim në pajtueshmëri me kërkesat e caktuara në paragrafin 1 brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e lëshimit të kësaj licence.

1. I Licencuari do të lidhë dhe do të mbajë në fuqi kontratën për sigurim në lidhje me stacionin e gjenerimit dhe pajisjet e ndërlidhura të përdorura për gjenerim. Një kontratë e tillë duhet të silllet çdo vit në ZRRE për tu shqyrtuar.

### **Neni 12: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit**

I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE-ja nuk e aprovon atë.

### **Neni 13: Sigurimi i Informacionit ndaj ZRRE- së**

1. I Licencuari do të dorëzojë në ZRRE, në mënyrë siq është përcaktuar me Nenin 23 dhe 24 të Rregullit për Liçencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe sa herë që ZRRE-ja mund të kërkojë, informatat dhe raporte të atilla që ZRRE-ja

mund ti konsideroi të nevojshme duke marrë parasysh Kushtet, ose siç mund të kërkojë për qëllimin e kryerjes së funksioneve që i janë caktuar ose transferuar sipas Nenit 29 të Rregullit për Licencim e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

2. Informata do të përgatitet në nivel të revizionimit (auditivit) ashtu siç mund të kërkojë nga ZRRE-ja kohë pas kohe.
3. Autoriteti i ZRRE-së për të kërkuar informacion sipas paragrafit 1 nuk limiton kompetencat e ZRRE-së që të kërkojë edhe ato informacione që konsiderohen konfidenciale sipas çdo Kushti ose Neni tjetër të kësaj Licence ose sipas Legjislacionit të aplikueshëm.
4. Nëse i Licencuari kërkon që një dokument i caktuar të konsiderohet si konfidencial atëherë është obligim i tij që të shënoj atë dokument si konfidencial dhe të arsyetojë kërkesën e tij sipas Rregullit mbi Konfidencialitetin e Informatave.
5. I Licencuari do të dërgoj ZRRE-së raportet tremujore dhe vjetore mbi veprimtarinë gjeneruese dhe pajtueshmërinë me Nenet dhe kushtet e licencës e që është në përputhje me Doracakun e Raportimit të nxjerr nga ZRRE-ja.
6. I Licencuari do të dërgoj ZRRE-së detalet e çdo ndryshimi të informatës së dërguar me aplikacion për këtë licencë.
7. Në këtë Nen

**"Informata"** do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokumente, shënime, llogari, vlerësime, kthime, raporte ose ngjarje që ndikojnë në siguri shëndet publik dhe ambient (të përgatitura me ose pa kërkesë të ZRRE-së) të çfarëdo përshkrimi dhe në çfarëdo formati të specifikuar nga ZRRE-ja.

#### **Neni 14: Arsyet për Përfundimin, Tërheqjen dhe Modifikim e Licencës**

1. ZRRE-ja mund të ndërpres këtë licencë në përputhje me nenin 39 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë në raste të:
  - a) mbarimit të afatit të Licencës;
  - b) me kërkesën e ndërmarrjes së licencuar të energjisë lidhur me licencën e tij;
  - c) shuarjen e personit juridik që posedon licencën;
  - d) shkatërrimin e objektit të energjisë termale;
  - e) me kërkesën e gjyqit që deklaron paaftësinë e të licencuarit ose vendimin e gjyqit për të ndërprerë aktivitetin e energjisë termale për shkak të deklarimit të të licencuarit për likuidim;
  - f) kur aktivitetet e licencuara të energjisë nuk janë kryer për më shumë se gjashtë (6) muaj, përveç kur suspendimi i aktivitetit është bërë me aprovim të ZRRE-së;
  - g) kur të jenë përmushur dispozitat e Nenit 44 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë; dhe
  - h) nëse ndonjë shumë për tu paguar si taksë nuk është paguar për tridhjetë (30) ditë pasi që është bërë borxh dhe mbetet e papaguar edhe për tridhjetë

(30) ditë pasi që ZRRE-ja të ketë njoftuar të Licencuarin me shkrim që pagesa nuk është paguar, duke ofruar që, një njoftim i tillë nuk duhet të ipet me herët se dita që vjen pas ditës kur pagesa është dashur të paguhet.

2. ZRRE-ja mund të tërheq këtë licencë në rastet në vazhdim, siç është caktuar në Nenin 44.5 të Rregullës për Licencim të Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ku thuhet që obligimet e të Licencuarit do të kryhen nga një i licencuar tjetër ose që konsumatorët nuk do të dëmtohen nga kjo tërheqje:
  - a) i licencuari nuk i përmbush ose shkel kushtet materiale ose obligimet e licencës dhe ajo mospërmbushje apo shkelja nuk janë kompensuar brenda afatit të dhënë nga ZRRE-ja ose seriozisht dëmtojnë kualitetin, sigurinë dhe seriozitetin e shërbimit që i Licencuari ka qenë i obliguar të ofrojë;
  - b) licenca e monitoruar nga ZRRE-ja ose inspektorati i Ministrisë së Energjisë dhe Minierave gjen dështimet në përmbushjen e kërkesave administrative dhe një dështim i tillë nuk është kompensuar brenda afatit të dhënë nga ZRRE-ja;
  - c) i Licencuari ka prezantuar informata materiale false sipas të cilave është dhënë licenca.
3. ZRRE-ja, në përputhje me Nenin 35 të Rregullës për Licencim të Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, mund të modifikoi këtë licencë në rastet në vazhdim:
  - a) me kërkesë të të Licencuarit;
  - b) kur kërkohet të mbrohet sistemi i ngrohjes në Kosovë, në lidhje me sigurinë e furnizimit apo mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve ose mbrojtjen e ambientit;
  - c) me qëllim të mbështetjes së kërkesave të reja të vendosura me marrëveshjet ndërkombëtare dhe ligjet kombëtare, rregulloret dhe legjislacionet e tjera të aplikueshme;
  - d) si sanksion për shkelje të termeve dhe kushteve të licencës, në përputhje me Nenin 44 të Rregullës për Licencim të Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

### **Neni 15: Taksat**

1. I Licencuari do ti paguaj ZRRE-së çdo taksë fillestare dhe vjetore të caktuar në Pasqyrën e Taksave e nxjerrur dhe e miratuar nga ZRRE-ja.
2. Taksa fillestare dhe vjetore është caktuar në bazë të Shtojcës A të Pasqyrës së Taksave.
3. Dështimi për të paguar kontributet vjetore dhe taksat në datat e caktuara me Pasqyrën e Taksave mund të qoj deri në tërheqjen e licencës.

### **Neni 16: Masat dhe Gjobat Administrative**

1. Në rast të shkeljes së ndonjë dispozite të Legjislacionit, të ndonjë Neni ose kushti të Licencës dhe ndonjë instruksioni të ZRRE-së për të Licencuarin, ZRRE-ja do të ketë pushtetin, sipas Nenit 56.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe

Rregullës për Gjobat dhe Masat Administrative ose të parandalojë të Licencuarin nga përsëritja e aktit ilegal ose nëse veprimi është ndërprerë, të lëshoj vendim rregullativ dh të kërkoj që të ndërmerret ndonjë veprim i veçant ose ti vihet një taks administrative të Licencuarit dhe/ose anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe/ose ekzekutivëve të tij.

2. Para lëshimit të gjobës, ZRRE-ja do të lëshoi një njoftim për shkelje të licencës dhe ti ofroj një mundësi të Licencuarit që brenda katërmbëdhjet (14) ditëve nga njoftimi ti përgjigjet ZRRE-së me shkrim, dhe të përmirësoj shkeljen.
3. Gjoba do t'i caktohet në përputhje me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullin për Masat dhe Gjobat Administrative.
4. Shuma e gjobës do të shqyrtohet në përputhje me Rregullin për Masat dhe Gjobat Administrative. Në çdo rast, nëse gjoba e përmendur në paragrafin 3 është vënë ndaj të Licencuarit ajo nuk duhet të tejkaloi 15% të të hyrave të vitit paraprak taksatues.
5. Nëse gjoba e përmendur në paragrafin 3 i është vënë Bordit të Drejtorëve ose ekzekutivi të të Licencuarit, nuk duhet të kaloj 300% të pagës së tyre vjetore.
6. Në rast të përsëritjes së shkeljeve, gjoba e vënë mund të jetë tri herë me e madhe se shumta e autorizuar në paragrafin 4 ose 5.
7. Kur të ngarkon një gjobë, në përputhje me këtë Nen, ZRRE-ja duhet të ketë parasysh shkallën e dëmtimit social të veprimit, sjelljen e mëparshme të personit, dhe gjendjen financiare të personit.
8. Nëse gjoba e ngarkuar nga ZRRE-ja nuk është paguar, ZRRE-ja do të inicioi procedurat gjyqësore për mbledhjen e gjobave si borxhe civile.

#### **Neni 17: Zgjidhja e Kontesteve**

1. Çdo kontest që paraqitet ose që është në lidhje me aktivitetin e licencuar do të caktohet në përputhje me Rregullën për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të miratuar nga ZRRE-ja.
2. Vendimet e ZRRE-së në lidhje me modifikimin, tërheqjen ose ndërprerjen e Licencës, si dhe ato në lidhje me ndonjë gjobë që rezulton nga shkeljet e licencës apo të legjislacioni të aplikueshëm, i Licencuari mund ti apeloj në gjykatën kompetente.